

VENDIM
Nr. 239, datë 20.4.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 688, DATË 18.11.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikave 1, shkronja “a”, dhe 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 688, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga fondet kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

PAGA MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
1	2	3
Për punonjësit e nivelit madhor	Drejtues madhor	133 700
	Drejtues i lartë	123 000
Për punonjësit e nivelit të lartë	Drejtues i parë	115 000
	Drejtues	106 000
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Kryekomisar	93 000
	Komisar	82 500
	Nënkomisar	75 000
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor i parë	64 000
	Inspektor i dytë	61 500
	Inspektor	59 000